



Prishtinë, 13 prill 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_967\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafet 1.11 dhe 1.12, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.2, dhe Neni 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 16 paragrafi 5, të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017); si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 10.11.2017 nga ndërmarrja "SharrCem" SH.P.K, adresa Rruga, "Adem Jashari" Nr.280, Hani i Elezit, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 13 prill 2018, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **LËSHOHET** licenca për Furnizim me energji elektrike ndërmarrjes "SharrCem" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li\_61/17 për periudhën nga **13 prill 2018** deri **12 prill 2023**, me mundësi vazhdimi sipas Nenit 32 në Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084.

## Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 10.11.2017 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me energji elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "SharrCem" SH.P.K.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe legjislacionit në fuqi.
- o Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në Rregullator duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në Rregullator për Licencë të Furnizimit me energji elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë ndonjë parregullsi të tij.



- Ndërmarrja "SharrCem" SH.P.K. me 23 & 24 dhjetor 2017 ka publikuar njoftimin në gazetë, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur. Palët e interesit nuk kanë kundërshtuar këtë aplikacion.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes "SharrCEm" SH.P.K. dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Rregullatori në përputhje me Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar. Në rastin konkret Rregullatori nuk ka mundur të veproj sipas afateve të përcaktuara me Rregullën për Licencim si rezultat i mungesës së kuorumit të Bordit të Rregullatori për vendimmarrje.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "SharrCem" SH.P.K.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i Rregullatorit**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar